

ABCOM sh.p.k.

**Pasqyrat financiare individuale të përgatitura sipas
Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

Përmbajtje

Raporti i Audituesit te Pavarur	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	2
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	3
Pasqyra e flukseve të parasë	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	5
3. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël	9
4. Emri i Mirë	13
5. Aktive afatgjata materiale	14
6. Aktive afatgjata jo materiale	15
7. Investime	15
8. Inventari	16
9. Llogari të arkëtueshme	16
10. Llogari të tjera të arkëtueshme	16
11. Mjete Monetare	17
12. Kapitali dhe rezervat	17
13. Qera Financiare	18
14. Llogari të pagueshme	18
15. Të ardhura të marra në avance	18
16. Detyrime të tjera rrjedhëse dhe të përlogaritura	18
17. Të ardhura	19
18. Të ardhura të tjera operative	19
19. Furnizim materiale dhe shërbime	19
20. Shpenzime personeli	19
21. Shpenzime të tjera operative	20
22. Të ardhurat/shpenzimet financiare	20
23. Shpenzimi i tatim fitimit	21
24. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	21
25. Ngjarje pas datës së raportimit	21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për ortaket e Shoqërisë Tregtare ABCOM Sh.p.k.

Opinionit

Unë kam audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABCOM Sh.p.k., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2017, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe Ligjin Per Kontabilitetin ne RSH.

Baza për Opinionin

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë e mia sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Unë jam i pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë dhe kam përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Unë besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Administrimin në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKN-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat e audituesit janë që të arrij një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojë një raport auditimi që përfshin opinionin tim. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të (Organizatës) në: [linku i faqes së internetit]. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

Tirane me 03.04.2018

Per EB Auditing Albania Shpk

Auditues i Pavarur
Erion BERBERI

Adresa:

Rruga: Rruga Pjetër Bogdani, Nr.7 , Tirane

Mob 0692028770

Lic. prof. Nr 310 ; NIPT L81521033C



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE T E VITIT 2017
te shoqerise ABCOM Sh.p.k.

I. Organizimi, objekti dhe kontributet, pronesia, administrimi dhe kapitalet.

Organizimi

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ABCOM" Shpk eshte regjistruar me vendim te gjykates te Tiranës. Shoqeria eshte e regjistruar edhe ne QKB me te gjitha ndryshimet duke bere perditesimin e tyre.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", nga statuti i saj dhe legjislacioni tjeter ne fuqi.

Kapitali i shoqerise eshte nenshkruar ne shumen **1.358.611.854** lek i cili eshte regjistruar dhe eshte derdhur totalisht.

Objekti i veprimtarise

Shoqeria "ABCOM" shpk si aktivitet te saj kryesor ka " Ndertime linja transmetimi per, internet, televizion, sherbime etj".

Administrimi

Shoqeria perbehet nga nje ortake ivetem dhe administrator i saj eshte z. GentiDaci.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane dhe ka filale ne disa rrethe te vendit.

II. Organizimi i kontabilitetit

Evidenca kontabel eshte organizuar ne perputhje te ligjit Nr.9228, dt.29.04.2004 "Per kontabilitetin e pasqyrat financiare".

Plani i llogarive gjate ketj viti eshte perpiluar ne perputhje me SNA dhe udhezimet perkatese. Dokumentacioni kontabel eshte perpunuar sipas rregullave. Dokumentat ndjekin rradhen kronologjike, kryqezohen dhe kontabilizohen ne menyre sistematike dhe korrekte ne program kompjuterik Financa 5 . Per vitin 2017 jane bere rregllisht ndryshimet ne politikat kontable.

U kontrolluan me zgjedhje regjistrimet dhe rezultoi se ato jane mbeshtetur ne dokumentet justifikues, faturat e furnitoreve kryesisht per blerje lende e pare dhe materiale te ndryshme, sherbimet realizua nga vet shoqeria, faturat e shitjes, dokumentat bankare, etj.



Llogarite vjetore per ushtrimin 2017 jane hartuar mbi bazen e parimit te vijimesise se veprimtarise dhe per rrjedhoje jane zbatuar parimet dhe rregullat e vleresimit te parashikuara nga kjo situata.

III. Politikat kryesore kontabel

Politikat kontabel te shoqerise reflektojne praktikat e ketij aktiviteti specifik.

- Aktivet Afatgjata materiale paraqiten ne bilanc me koston historike minus amortizimin e akumuluar te llogaritur per kohen e shfrytezimit te tyre si dhe cvlersime te ketyre aktiveve.

- Transaksionet e kryera jane bere me leke dhe euro dhe Usd, dhe gjendja ne banke ne fund te vitit eshte pasqyruar sakte duke e vleresuar valuten me kursin e dites fundit vitit duke kaluar ne rezultat diferencat e kursit.

IV. Shenime mbi llogarite vjetore

A. AKTIVET

1. Aktive afatshkurtra paraqiten ne bilanc ne shumen **316.740.123** leke dhe sipas posteve jane si me poshte:

1.1 Aktivet monetare

Me daten 31.12.2017 vlerat monetare te shoqerise paraqiten ne bilanc me shumen **178.187.273** leke;

Gjendje e bankes	159.128.865 leke
Gjendje e arkes	18.190.636 leke
Mjete monetare ne tranzit	867.773 leke

Arka eshte mbajtur me dokumenta te rregullta mandat arketimi dhe pagese.

1.2 Te drejta te arketueshme afatshkurtra paraqiten ne bilanc per shumen **138.552.850** leke dhe perbehen si vijon:

- Kerkesat per arketim mbi klientet	72.006.726 leke
- Gjendje debitore tvsh, tatim fitimi	49.166.351 leke
. Gjendje te inventarit	17.379.773 leke

Ne fund te vitit sipas inventarit te paraqitur shoqeria disponon **17.37.773** leke te cilat jane karta e lende te para ne shumen 409.855 leke materiale promocionale ne shumen 3.035.277 leke dhe aksesore te ndryshem 13.934.641 leke.

1.2 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra jane ne shumen 49.166.351 leke dhe analzoen si vijon:

- Parapagime per furnitore	29.182.661 leke
----------------------------	-----------------



Shpenzime te periudhave te jashtme	15.242.916 leke
Detyrime te ponareve te STAR TV	2.657.023 leke
Parapagime ne pritje per proc.gjyqsore	1.100.270 leke
TVSH e arktueshme	75.089 leke
Te tjera	908.392 leke

2. Aktivet afatgjata paraqiten ne bilanc ne shumen **3.259.041.828** leke dhe sipas posteve jane si me poshte:

2.1 Investime financiare afatgjata jane ne shumen	42.313.500 leke.
2.2 Takse e shtyre	49.604.268 leke
2.3 Emri i mire	483.772.303 leke
2.4 Aktive te tjera jomateriale	4.348.959 lek

2.3 Aktive afatgjata materiale jane paraqitur ne bilanc me vleren kontable (koston e marrjes minus amortizimin e llogaritur per kohen e perdorimit te tyre), pasqyre e cila eshte paraqitur ne shenimet shpjeguese. Me date 31.12.2017 AAM-te jane ne vleren neto sipas zerave te meposhtem:

- Ne fund te vitit AAM jane me vlere te mbetur. Shuma kontable neto e AAM-ve **2.679.002.798** leke

Gjendja e aktiveve afatgjata materiale vertetohet me gjendjen e bilancit te vitit 2016 dhe ndryshimet ne vitin 2017, sipas pasqyres.

Llogaritja e amortizimit vjetor dhe cvelresimi eshte bere mbi bazen e ligjit nr.8438 dt.28.12.1998 dhe udhezimeve te Ministrise se Financave. Shuma e llogaritur e amortizimit per vitin 2017 eshte 537.685.340 leke.

Shuma e aktivitet te bilancit me date 31.12.2017 eshte **3.575.781.951** leke.

B. DETYRIMET DHE KAPITALI

1. Detyrimet afatshkurtra

Per vitin 2017 pasivet afatshkurtra jane ne shumen **558.248.741** leke dhe sipas posteve jane si me poshte:

1.1 Qera financiare	2.195.226 leke perbehen si vijon:
- Te pagueshme ndaj furnitoreve	79.657.277 leke
- Detyrim per tatim fitimin	2.150.499 leke
- Te ardhura te perfituara ne avance	180.989.596 leke
- Detyrime te tjera e te perlllogaritura	293.256.143 leke

2. Detyrimet afatgjata

Detyrimet afatgjata jane qera financiare ne shumen **636.044** leke.



3. Kapitali dhe rezervat

Ne bilancin e shoqerise kapitalet e veta jane gjithsej 3.016.897.166 leke te cilat perbehen nga:

- Kapitali i nenshkruar	1.398.611.854 leke
- Rezervat te jera	1.454.585.900 leke
- Fitimi i ushtrimit	203.699.412 leke

Fitimit te periudhes dhe dividenteve te parapaguar per vitin 2017 ti caktohet destinacioni nga ortaku.

C. REZULTATI FINANCIAR

Per vitin 2017 shoqeria "ABCOM " Shpk ka realizuar te ardhura ne shumen 1.791.535.490 leke nga shitja e sherbimeve dhe furnizime materiale 51.861.532 leke dhe e ardhura te tjera financiare ne shumen 7.927.061 leke Shpenzimet e aktiviteti jane si vijon:

- Shpenzimet per materialet e sherbime	418.725.249 leke
- Shpenzimet per personelin, etj	314.922.783 leke
- Amortizimi dhe zhvleresimet	537.685.340 leke
- Shpenzimet te tjera operative	245.785.561 leke
- Borxh i keq	3.565.328 leke
Totali i shpenzimeve te aktivitetit	1.307.898.700 leke
Shpenzime financiare nga kursi kembimit	12.373.952 leke
Fitimi para tatimit eshte ne shumen	318.265.870 leke
Shpenzimet e tatim fitimit	51.508.540 leke
Fitimi neto i vitit financiar	266.757.330 leke

Rezultati financiar per vitin 2017 ka qene me nje norme fitimi prej 14.48% ndaj normes se fitimit prej 16% qe ka qene ne vitin 2016.

Nga sa me siper treguesit e aktivitetit operativ te shoqerise "ABCOM " Shpk jane te konsoliduar.

Te gjitha anekset e tjera e pasqyrave financiare jane plotsuar sipas kerkesave te ligjit dhe SNA.

Tirane me 03.04.2018

Per EB Auditing Albania Shpk
Auditues i Pavarur
Erion BERBERI



Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Të gjithë shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016 Ripasqyruar me SNK	1 Janar 2016 Ripasqyruar me SNK
		<i>Në Lek</i>	<i>Në Lek</i>	<i>Në Lek</i>
Aktivët				
Emri I Mirë	4	483,772,303	110,392,113	110,392,113
Aktive afatgjata material, neto	5	2,679,002,798	2,477,682,084	2,447,987,749
Aktive afatgjata jomateriale, neto	6	4,348,959	10,256,840	14,974,057
Takse e shtyrë aset	23	49,604,268	33,984,105	31,923,524
Investime	7	42,313,500	512,513,740	544,876,433
Total aktive afatgjata		3,259,041,828	3,144,828,882	3,150,153,876
Inventare	8	17,379,773	11,335,900	14,242,451
Llogari te arkëtueshme	9	72,006,726	64,149,433	73,119,377
Llogari të tjera të arkëtueshme	10	49,166,351	98,542,426	103,565,066
Tatim fitimi I parapaguar	23	-	6,426,265	-
Mjete Monetare	11	178,187,273	111,875,945	93,800,107
Total aktive afatshkurtra		316,740,123	292,329,969	284,727,001
Total Aktive		3,575,781,951	3,437,158,851	3,434,880,877
Kapitali				
Kapitali I regjistruar	12	1,358,611,854	1,365,244,354	1,365,244,354
Rezerva të tjera	12	1,454,585,900	1,148,165,662	754,148,869
Fitim I pashpërndarë	12	203,699,412	293,753,869	393,034,718
Total kapitali		3,016,897,166	2,807,163,885	2,512,427,941
Detyrime				
Qera Financiare	13	636,044	2,855,555	6,806,405
Total detyrime afatgjata		636,044	2,855,555	6,806,405
Qera Financiare	13	2,195,226	6,501,988	6,466,862
Llogari të pagueshme	14	79,657,277	85,277,362	123,951,494
Detyrim Tatim Fitimi	23	2,150,499	-	9,997,980
Të ardhura të përfituara në avancë	15	180,989,596	175,706,278	172,546,130
Detyrime të tjera rrjedhëse dhe të përlogaritura	16	293,256,143	359,653,783	602,684,065
Total detyrime afatshkurtra		558,248,741	627,139,411	915,646,531
Total detyrime		558,884,785	629,994,966	922,452,936
Total kapitali dhe detyrime		3,575,781,951	3,437,158,851	3,434,880,877

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

(Të gjithë shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

	Shënime	2017	31 Dhjetor 2016
		Në Lek	Ripasqyruar me SNK Në Lek
Të ardhura	17	1,791,535,490	1,748,442,345
Të ardhura të tjera operative	18	51,861,532	68,037,461
Furnizim materiale dhe shërbime	19	(418,725,249)	(422,087,099)
Shpenzime për personelin	20	(314,922,783)	(315,215,471)
Borxh i keq	9	(3,565,328)	(3,197,918)
Shpenzime të tjera operative	21	(245,785,561)	(233,604,319)
<i>Fitimi para amortizimit, zhvlerësimit, kostove dhe të ardhurave financiare, tatimit</i>		860,398,100	842,374,998
Zhvlerësimi i Emrit të Mirë		-	-
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	5,6	(537,685,340)	(481,483,606)
Fitimi nga operacionet		322,712,761	360,891,393
Të ardhura financiare	22	7,927,061	11,087,323
Shpenzime financiare	22	(12,373,952)	(17,824,463)
Kosto financiare neto		(4,446,891)	(6,737,140)
Fitimi para tatimit		318,265,870	354,154,253
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(51,508,540)	(59,418,309)
Fitimi neto për vitin		266,757,330	294,735,944
Të ardhura dhe shpenzime të tjera përmblëdhëse për vitin			
Diferenca konvertimi		-	-
Fitimi total përmblëdhës për vitin		266,757,330	294,735,944

Pasqyra e Flukseve te Parase

(Të gjithë shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

		2017	2016
		Në Lek	Ripasqyruar me SNK Në Lek
Fluksi monetar nga veprimtaria operative			
Fitimi neto per vitin		266,757,330	294,735,944
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,6	537,685,340	481,483,606
Humbje të porealizuara nga kursi I këmbimit		(763,458)	1,580,681
Fitime nga shitja e aktiveve afatgjata		(25,166,600)	(30,819,634)
Shpenzime tatim fitimi	23	51,508,540	59,418,309
Të ardhura nga interesi		(18,796)	(38,787)
Shpenzime interesi		629,817	4,014,709
Borxh I keq	9	3,565,328	3,197,918
Zvogëlim kapitali		(6,632,500)	-
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues			
		827,565,002	816,676,198
Ndryshimi në inventare		(6,675,210)	(4,231,760)
Ndryshimi në llogari te arkëtueshme		(10,980,671)	2,549,042
Ndryshimi në llogari të tjera të arkëtueshme		45,606,488	3,486,181
Ndryshimi në llogari të pagueshme		(5,294,475)	(38,643,864)
Ndryshimi në të ardhura të përfituara në avance		5,283,327	3,160,149
Ndryshimi në detyrime të tjera rrjedhëse dhe të përlogaritura		1,867,380	(2,331,395)
Fluksi monetar I gjeneruar nga operacionet			
		857,371,841	775,899,713
Tatim Fitimi I paguar		(58,551,939)	(77,971,501)
Interesi I paguar		(629,817)	(4,014,709)
Interesi I arketuar		18,799	38,787
Flukset neto nga aktivitetet operative			
		798,208,884	693,952,290
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerja e kompanive		(104,988,974)	(205,091,618)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(669,500,130)	(531,708,647)
Të ardhura nga shtija e aktiveve afatgjata materiale		49,117,821	67,411,837
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale		-	(793,777)
Flukset neto të përdorura në aktivitetet investuese			
		(725,371,283)	(670,182,205)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Financime nga qeraja financiare		-	-
Pagesa për detyrimet e qerasë financiare		(6,526,273)	(7,355,633)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet financuese			
		(6,526,273)	(7,355,633)
Rritja neto në mjete monetare		66,311,328	18,075,838
Mjete Monetare në 1 Janar		111,875,945	93,800,107
Efekt konvertimi			
Mjete Monetare në 31 Dhjetor			
	11	178,187,273	111,875,945

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital

(Të gjithë shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

	Kapitali i regjistruar	Rezerva të tjera	Fitime të pashpërndara	Total
Në 1 Janar 2016 sipas SKK	1,365,244,354	1,084,460,999	393,034,718	2,842,740,071
Impakti I tranzicionit ne SNK	-	(330,312,133)	-	(330,312,133)
Në 1 Janar 2016 ripasqyruar me SNK	1,365,244,354	754,148,869	393,034,718	2,512,427,941
Fitimi përmbledhës për vitin	-	-	294,735,944	294,735,944
Kalimi i fitimit në rezervë	-	394,016,793	(394,016,793)	-
Gjëndja në 31 Dhjetor 2016	1,365,244,354	1,148,165,662	293,753,869	2,807,163,885
Fitimi përmbledhës për vitin	-	-	266,757,330	266,757,330
Zvogëlim në kapitalin e regjistruar	(6,632,500)	-	-	(6,632,500)
Kalimi I fitimit në rezervë	-	306,420,269	(306,420,269)	-
Fitimi I pashpërndarë kompanitë e përthithura	-	-	(50,391,549)	(50,391,549)
Gjëndja në 31 Dhjetor 2017	1,358,611,854	1,454,585,900	203,699,412	3,016,897,166

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë aprovuar nga drejtuesit e saj më 15 Shkurt 2018 dhe janë firmosur në emër të tyre nga:

Genti Daci

Genti Daci
Administrator



1. Informacion i përgjithshëm

Abcom sh.p.k. ("Shoqëria") është krijuar më datën 16 Prill 1998. Shoqëria është regjistruar në autoritetet tatimore me Numër Identifikimi të Personit të Tatuashëm (NIPT) K11308001B.

100% e kuotave të shoqërisë zotërohen nga American Broadband B.V. me seli në Holandë.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është ndërtim rrjetesh telekomunikacioni dhe ofrimi i shërbimeve të telekomunikacionit, internetit, telefonisë fikse, televizion me pagesë, etj. nëpërmjet sistemeve kablore.

Administratorë të shoqërisë janë Z. Genti Daci dhe Z. Altin Leksani.

Selia e shoqërisë është në Rr. Reshit Collaku, mbrapa Albtelekom, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria e kryen aktivitetin e saj në disa qytete të Shqipërisë. Shtrirja gjeografike e shërbimeve të kompanisë përfshin qytetet Tiranë, Shkodër, Lezhë, Krujë, Laç, Elbasan, Durrës, Lushnjë, Kuçovë, Fier, Vlorë, Librazhd, Pogradec, Korçë, etj.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike. Monedha e raportimit është Leku Shqiptar ("Lek") që është gjithashtu edhe monedha funksionale.

Shoqëria mban librat e saj kontabel dhe publikon pasqyrat e saj statutore financiare në përputhje me Ligjin e Kontabilitetit Nr. 9228 date 29 prill 2008 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF, të cilat u bënë të detyrueshme në Shqipëri në bazë të vendimit të Ministrisë së Financave Nr. 65, dt. 05.05.2008, "Për publikimin dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe".

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare netohen kundrejt njëra tjetrës dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjërishme e zbatueshme për të netuar shumën e njohura dhe ka qëllim shlyerjen e tyre mbi bazë neto, ose të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk netohen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, përveç nëse kërkohet ose lejohet nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet e tyre, dhe sic parashikohet në menyrë specifike në politikat kontabël të Shoqërisë.

2.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive në periudhën aktuale

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2016:

- SNRF 14 Llogaritë e Shtyra për Efekte Rregullatore
- SNRF 11 Marreveshjet e perbashkëta (Ndryshuar): Kontabiliteti i Blerjes së Interesave në Operacione të Përbashkëta
- SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe SNK 38 Aktivët jo-Materiale (Ndryshuar): Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit
- SNK 16 dhe SNK 41 Bujqesi: Bimet Prodhuese (Ndryshuar)
- SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshuar)
- Përmirësimet Vjetore për SNRF-të Ciklit 2012 – 2014
- SNK 1: Iniciative e Shenimeve Shpjeguese (Ndryshuar)
- SNRF 10, SNRF12 dhe SNK 28: Subjektet Investuese: Aplikimi i Perjashtimit nga Konsolidimi (Ndryshuar)

Megjithëse keto standarde dhe ndryshime të reja janë aplikuar për herë të parë duke filluar nga 1 Janar 2016, ato nuk kanë patur impakt material në pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë. Natyra dhe ndikimi i cdo standardi dhe ndryshimi është përshkruar si vijon:

- SNRF 14 Llogaritë e Shtyra për Efekte Rregullatore

-

SNRF 14 është një standard opsional që i lejon subjektet aktivitetet e të cilave janë subjekt i rregullimit të tarifave, të vazhdojnë aplikimin e politikave kontabile ekzistuese për balancat e llogarive e shtyra rregullatore gjatë adoptimit për herë të parë të IFRS-ve. Entitetet që adoptojnë SNRF 14 duhet të prezantojnë llogaritë e shtyra rregullatore veçmas nga zërat e tjerë në pasqyrën e pozicionit financiar dhe të shfaqin levizjet në keto llogari veçmas nga zërat e tjerë në pasqyrën e fitimit humbjes and të të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Standardi kërkon që shënimet shpjeguese të sqarojnë natyrën dhe riskun e lidhur me tarifat e rregulluara të entitetit dhe efektet e tyre në pasqyrat financiare.

Meqenëse Shoqëria është një përgatitese e pasqyrave sipas SNRF-ve dhe nuk është e përfshirë në ndonjë aktivitet me tarifa të rregulluara nga agjensi shtetërore, ky standard nuk është i aplikueshem.

- SNRF 11 Marreveshjet e përbashkëta (Ndryshimi): Kontabiliteti i Marrjes së Interesave në Operacione të Përbashkëta

Ndryshimi i SNRF 11 kërkon që kontabiliteti i një operatori të përbashkët që investon në një tjetër operator të përbashkët i cili përben një biznes duhet të aplikojë principet dhe kontabilitetin e SNRF 3 Kombinimet e Biznesit. Standardi sqaron se një investim i mëparshëm në një operacion të përbashkët nuk rimatet edhe kur investimi rritet në të njëjtin operacion të përbashkët për sa kohë që kontrolli i përbashkët nuk ndryshon. Gjithashtu amendimi i SNRF 11 sqaron se nuk aplikohet për palet të cilat kanë kontroll të përbashkët në një operacion duke përfshirë entitetin raportues, të cilat janë të kontrolluara nga një pale tjetër. Amendimet janë të aplikueshme si për blerjen e investimeve fillestare në operacionet e përbashkëta ashtu edhe për blerjen e çdo investimi shtesë në të njëjtin operacion të përbashkët dhe zbatohen në mënyrë prospektive.

Këto ndryshime nuk kanë ndikim tek shoqëria pasi nuk ka pasur asnjë investim në një operacion të përbashkët gjatë periudhës.

2.2 Standarde, interpretime dhe amendime efektive në periudhen aktuale (vazhdim)

- SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe SNK 38 Aktivitet jo-Materiale (Ndryshimi): Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit

Ky ndryshim sqaron parimin e SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe SNK 38 Aktivitet Jo-materiale, ku të ardhurat pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë të gjeneruara nga veprimtaria e një biznesi (ku aktivi bën pjesë) në vend të përfitimeve ekonomike që konsumohen përmes përdorimit të aktivitetit. Si rezultat, raporti i të ardhurave i krijuar mbi të ardhurat e përgjithshme të pritshme për t'u gjeneruar nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar aktivitet afatgjatë materiale, por mund të përdoret vetëm në raste shumë të rralla për të amortizuar aktivitet jo-materiale. Amendimet aplikohen në mënyrë prospektive dhe nuk ndonjë impakt tek Shoqëria pasi nuk përdor metode amortizimi të bazuar mbi të ardhurat.

- SNK 16 dhe SNK 41 Bujqësi: Bimet Prodhuese (Ndryshimi):

Amendimet ndryshojnë kërkesat e kontabilitetit për aktivitet biologjik që plotësojnë perkufizimin e bimëve prodhuese. Sipas ndryshimeve, aktivitet biologjik që plotësojnë perkufizimin e bimëve prodhuese nuk do të jenë brenda objektit të SNK 41. Në vend të kësaj, SNK 16 do të zbatohet. Pas njohjes fillestare, bime prodhuese do të matet në bazë të SNK 16 me kosto të akumuluar (para maturimit) duke përdorur ose modelin e kostos ose modelin e rivlerësimit (pas maturimit). Ndryshimet gjithashtu kërkojnë që prodhimi që rritet në bimët prodhuese do të mbetet në objektin e SNK 41 i matur me vlerën e drejte minus kostot për shitje.

Për grantet qeveritare të lidhura me bimët prodhuese, SNK 20 Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndiqjen Qeveritare do të zbatohet. Ndryshimet do të aplikohen në mënyrë retrospektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2016, duke lejuar adoptim më të hershem. Këto ndryshime nuk priten të ketë ndonjë ndikim pasi Shoqëria nuk ka bime prodhuese si asete.

- SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshuar)

Këto ndryshime lejojnë entitetin të përdorë metodën e kapitalit për të kontabilizuar investimet në filiale, pjesëmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrjet në pasqyrat financiare individuale. Entitetet që aplikojnë momentalisht SNRF dhe kërkojnë të ndryshojnë në metodën e kapitalit në pasqyrat e tyre individuale duhet ta aplikojnë këto ndryshime në mënyrë retrospektive. Këto ndryshime nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2012-2014

Këto përmirësime përfshijnë:

- SNRF 5 – Aktivitet afatgjatë të mbajtura për shitje dhe operacionet jo të vijueshme: Aktivitet (ose Shoqëritë për tu nxjerrë në hitje) përgjithësisht nxirren nga librat kontabel ose nëpërmjet shitjes së tyre ose shpërndarjes së tyre tek pronarët. Ndryshimi sqaron se kalimi nga një plan nxjerrje jashtë tek tjetri nuk konsiderohet një plan i ri nxjerrje jashtë librave kontabel, por një vazhdim i planit ekzistues. Në këtë kuptim nuk ka ndërprerje të aplikimit të kërkesave të SNRF 5. Ky ndryshim aplikohet në mënyrë prospektive.

- SNRF 7 – Instrumentat financiarë: Shënime shpjeguese

(i) Kontratat e shërbimit

Ky ndryshim sqaron se kontratat e shërbimit që përfshijnë tarifa mund të përfaqësojnë përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar. Entiteti duhet të vlerësojë natyrën e tarifës dhe angazhimin, përkundrejt orientimit të përfshirjes së vazhdueshme të SNRF 7 me qëllim që të vlerësohet nëse janë të nevojshme shënime shpjeguese. Vlerësimi për të cilin kontrata e shërbimit përfaqëson një përfshirje të vazhdueshme duhet

të bëhet në menyrë retrospektive. Sidoqoftë, shënimet shpjeguese nuk është e nevojshme të jepen për periudhat të cilat fillojnë përpara vitit në të cilin entiteti aplikon për herë të parë ndryshimet.

(ii) Aplikueshmëria e ndryshimeve të SNRF 7 për pasqyrat financiare të ndërmjetme të permbledhura. Ndryshimi sqaron se kërkesat për shënime shpjeguese për netimin, nuk aplikohen për pasqyrat financiare të ndërmjetme të permbledhura, por rasteve kur shënime shpjeguese japin një informacion të rëndësishëm në lidhje me informacionin e raportuar në raportin më të fundit vijtor. Ky ndryshim aplikohet në menyrë retrospektive.

- **SNK 19 – Perfitimet e punonjësve:** Ndryshimi sqaron që thellesia tregtare e obligacioneve të korporatave me cilesi të lartë vlerësohet bazuar në monedhen në të cilën është obligacioni, me shume se sa nga shteti ku ndodhet ky obligacion. Kur nuk ka një treg aktiv për obligacione të korporatave me cilesi të lartë në atë monedhe, duhet të perdoren obligacionet qeveritare. Ky ndryshim aplikohet në menyrë prospektive.
- **SNK 34 – Raportimi financiar i ndërmjetëm:** Ndryshimi sqaron se shënime shpjeguese të ndërmjetme duhet ose të jenë në pasqyrat financiare të ndërmjetme ose të përfshihen nëpërmjet kryqezimit të informacionit ndërmjet pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe çdo vendi tjetër në të cilën ato janë përfshirë në raportin financiar të ndërmjetëm (p.sh., në raportin e riskut apo raportin e manaxhimit). Informacioni tjetër në raportin financiar të ndërmjetëm duhet të jetë në dispozicion të përdoruesve me të njëjtat kushte si dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme si dhe në të njëjtën kohë. Ky ndryshim aplikohet në menyrë retrospektive. Këto ndryshime nuk kanë ndikim për Shoqërinë.
- **Ndryshimet në SNK 1 – Paraqitja e shënimeve shpjeguese:** Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare sqarojnë sesa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:
 - Materialitetin sipas kërkesave të SNK 1
 - Rreshtat specifik mund të ndahen në pasqyrën e fitimit, humbjeve dhe të ardhurave të tjera dhe në pasqyrën e pozicionit financiar,
 - Subjektet kanë fleksibilitet për sa i përket rendit në të cilën ata paraqesin shënime për pasqyrat financiare
 - Pjesa e të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit neto duhet të paraqiten si një zë në total, dhe të klasifikuar mes atyre artikujve që do apo nuk do të jenë më pas të riklasifikuar në fitim ose humbje
 - Për më tepër, ndryshimet qartësojnë kërkesat që zbatohen kur nëntotale shtesë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe deklaratën / deklaratat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera. Këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë ndikim për Shoqërinë.
- **Ndryshime në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 Entitetet Investuese: Aplikimi për shmangie nga konsolidimi:** Ndryshimet adresojnë çështje të cilat janë ngritur në aplikimin e shmangies së shoqërive investuese sipas SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara. Ndryshimet në SNRF 10 sqarojnë se shmangia nga prezantimi i pasqyrave financiare të konsoliduara është i aplikueshëm për një shoqëri meme e cila është filial i një entiteti investues, kur entiteti investues mat të gjithë filialet e saj me vlerë të drejtë. Për më tepër, ndryshimi në SNRF 10 sqaron se vetëm një filial i një entiteti investues që nuk është në vetvete një entitet investues dhe që jep shërbime mbështetëse entitetit investues konsolidohet. Të gjithë filialet e tjerë të entitetit investues maten me vlerë të drejtë. Ndryshimet në SNK 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe Siperparrjet e Përbashkëta lejojnë investitorin, kur aplikohet metoda e kapitalit, të mbaje vlerën e drejtë të aplikuar nga entiteti investues për interesin e tij në filiale. Këto ndryshime aplikohen në menyrë retrospektive dhe nuk kanë ndikim për Shoqërinë pasi Shoqëria nuk përdor shmangien nga konsolidimi.

2.3 Standarte të emetuara por që ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe nuk janë adoptuar

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi, deri në datën e deklaramit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë pasqyruar më poshtë. Shoqëria synon të adoptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të behen efektive.

- SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja

Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 janar 2018, por lejohet adoptimi i hershëm. Faza përfundimtare e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjithë versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët**

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas dates 1 janar 2017. SNRF 15 percakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrise. Kërkesat e standardit do të aplikohen gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve financiare që nuk janë një prodhim i veprimtarive të zakonshme të entitetit (p.sh., shitja e pronës, impiantit dhe pajisjeve apo të paprekshmeve). Dhënia e gjere e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, perfshi ndarjen e të ardhurave totale, informacionin rreth detyrimeve të performancës, ndryshimet në ekuilibrat e logaritjeve të aktiveve dhe pasiveve të kontrates, ndërmjet periudhave, gjykimeve dhe preventivave kryesore. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 16 - Qiratë**

BSNK publikoi standartin e ri për kontabilizimin e qirave - SNRF 16 Qiratë në Janar 2016. Standarti i ri nuk ndryshon shumë kontabilizimin e qirave nga qeradhenësit. Megjithatë, kerkon që qiramarrësit të njohin në bilancin e tyre kontabel të gjitha qiratë si detyrime me të drejta korresponduese aktivet në përdorim. Qiramarrësit duhet t përdorin një model të vetëm për njohjen e të gjitha qirave, por do të kenë opsionin të mos njohin qiratë afatshkurtra ose qiratë për aktive me vlera të vogla. Në përgjithësi, modeli i njohjes do jetë i ngjashëm me atë qe përdoret aktualisht për kontabilizimin e qirave financiare, me interesin dhe shpenzimin e amortizimit të njohur në zera të vecante të pasqyres së fitimit ose humbjes.

SNRF 16 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Janar 2019. Aplikimi më herët është i lejuar nese standarti i ri i te ardhurave, SNRF 15 aplikohet ne të njejtën datë. Qiramarrësit duhet të adoptojnë SNRF 16 duke përdorur ose metodën e plotë retrospektive ose metodën e modifikuar retrospektive.

Shoqëria nuk synon të aplikojë këtë standart perpara hyrjes së tij në fuqi dhe po vlerëson impakin e tij.

- **SNK 7 – Iniciativa per shenimet shpjeguese (ndryshimet)**

Ne Janar 2016 BSNK publikoi ndryshime në SNK 7 Pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare me qëllimin e përmirësimit të shënimeve shpjeguese për aktivitetet financuese dhe të ndihmoje përdoruesit për të kuptuar më mire pozicionin likuid të entitetit raportues. Sipas kërkesave të reja, entitetet do të duhet të paraqesin shënime shpjeguese për ndryshimet në detyrimet financiare si rrjedhojë e aktivitetëve financuese të tilla si ndryshimet në zerat monetare dhe jo-monetare (p.sh. humbjet dhe fitimet nga levizja e kurseve të kembimit. Ndryshimi hyn në fuqi me 1 Janar 2017. Shoqëria po vlerëson ndikimin e këtij standarti

- **SNK 12 – Njohja e aktivitetit të shtyre për humbje të përealizuara – Ndryshimi në SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat**

Ne janar 2016, me nxjerrjen e ndryshimeve të SNK 12, BSNK sqaron trajtimin kontabël të aktiveve tatimore të shtyra të instrumentave të huave të cilat maten me vlerë të drejtë për efekte kontabël, por maten me kosto për qelime fiskale. Ndryshimi hyn në fuqi me 1 Janar 2017. Shoqëria po vlerëson momentalisht ndikimin e këtij ndryshimi por nuk pret të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare.

- **SNRF 2 – Klasifikimi dhe matja e Transaksioneve të “Pagesave të bazuara në aksione” — Ndryshimi në SNRF 2**

BSNK publikoi ndryshime në SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione që adresojnë keto tre fusha: efekt te “konditave të kushtezimit” mbi matjen e transaksioneve të pagesave të bazuara në kasione të shlyera nëpërmjet mjeteve monetare; klasifikimin e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione me kushte për shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim; dhe kontabilizimin ku një modifikim i kushteve dhe termave të pagesave bazuar në aksione ndryshojnë klasifikimin nga të pagueshme me mjete monetare në të pagueshme me kapital.

Entitetet kerkohet të aplikojnë ndryshimet pa riparaqitur periudhat e mëparshme, por aplikimi retrospektiv është i lejuar për të tre ndryshimet dhe nëse arrihen edhe kritere te tjera. Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Janar 2018, me aplikim te me hershem te lejuar. Shoqëria po vlerëson efektin potencial të këtyre ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

Shoqëria ka zgjedhur të mos i implementojë keto standarde, rishikimeve dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Entitetit në periudhen e aplikimit fillestar.

3. GJYKIME DHE VLERESIME TË RËNDESISHME KONTABILE

Në aplikimin e politikave kontabel të Shoqërisë, që përkruhen në Shenimin nr 4, drejtimi i kërkohet që të beje gjykime, cmuarje, dhe supozime për vlerën kontabel të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime të tjera. Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjere që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto cmuarje.

Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në cmuarjet kontabel do të njihen në periudhën në të cilën cmuarja është rishikuar nëq rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudha të ardhshme nëq rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

Pasiguria në gjykime

Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen në vlerën në të cilën vlera kontabel e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të parase tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njësi gjeneruese e parase dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parase.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon rregullisht jetët e dobishme të aktiveve të amortizueshme në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson nese jeta e përcaktuar si e dobishme e aktiveve, përfaqëson dobishmerine e pritur të aktiveve. Vlerat kontabel e këtyre aktiveve analizohet në Shenimin 5 dhe Shenimin 6. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të vjetërimit teknologjik dhe faktoreve të tjerë.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Zhvlerësimi i llogarive të arketueshme dhe të tjera të arketueshme

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për llogaritë e arketueshme dhe për llogarite e tjera të arketueshme bazuar në humbjet e vlerësuar që rezultojnë nga paaftësia e klientëve për të bërë pagesat e kërkuara. Vlerësimi është bazuar në vjetërimin (aging) e gjëndjes së llogarive të arketueshme dhe përvojën historike të shlyerjes, kreditin e konsumatorëve dhe ndryshimeve në aspektin e pagesave të konsumatorëve gjatë vlerësimit të humbjes nga zhvlerësimi për llogarite e dyshimta. Keto përfshijnë supozime mbi sjelljen e konsumatorëve dhe mbledhjen e mjeteve monetare të ardhshme që rezultojnë prej saj. Nëse gjendja financiare e klientëve do të përkeqësohet, zhvlerësimi aktual i llogarive të arketueshme ekzistuese mund të jetë më i lartë se sa pritjet dhe mund të tejkalojë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani.

Inventarët

Inventari fillimisht rregjistrohen me kosto, që përbehet nga cmimi i blerjes duke shtuar dhe kostot e drejtperdrejta si transport dhe parking, akcize, kosto e analizes së cilësisë të mallit të importit dhe taksat e agjensise doganore.

Inventari më pas paraqitet me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kur përcakton vlerën neto të realizueshme, drejtimi merr parasysh provat me objektive / të dhënat në dispozicion të marra gjatë kryerjes së vlerësimeve.

Vlera neto e realizueshme është e vlerësuar me cmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus shpenzimet e nevojshme për të bërë produktin gatë për t'u shitur.

3.1 Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhe të huaj janë të konvertuara në lekë dhe regjistrohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët monetare dhe zëra të tjerë jo monetarë në monedhë të huaj rivlerësohen në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e fundit të periudhës raportuese. Diferencat e këmbimit valutor janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirë të Shoqërisë.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për perkthimin e zerave të pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj paraqiten si vijon (në Lekë):

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	134.09	128.17

3.2 Aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale

Aktivitet afatgjata material dhe jo materiale janë deklaruar me vlerën kontabel neto, pas zbritjes së amortizimit të akumuluar dhe/ose humbjeve të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kjo kosto historike përfshin shpenzimet që lidhen direkt me blerjen e aktiveve. Kosto e aktiveve të ndertuara vetë përfshin koston e lëndëve të para dhe punës, dhe cdo kosto tjetër që lidhet direkt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune, koston e cmontimit dhe heqjes së mjeteve dhe rikonstruksioni i vendit ku ato janë vendosur dhe koston e kapitalizuara të huamarrjes.

Koston shtesë janë përfshirë në vlerën e aktivitet ose njihet si një aktiv i vecantë, sipas nevojës, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me artikullin do të hyjnë në Shoqeri dhe kostoja e artikullit mund të matet me besueshmeri. Të gjitha riparimet dhe mirembajtjet e tjera, ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilën ato kryhen.

Jetegjatësia e aktiveve është si më poshtë:

• Instalime të përgjithshme dhe sisteme telekomunikacioni	2-10 vjet
• Ndertesa	5 vjet
• Mjete transporti	5 vjet
• Pajisje zyre dhe informatike	3-5 vjet

Vlerat e mbetura dhe jeta e përdorimit të aktiveve janë rishikuar, dhe rregulluar nëse është e pershtatshme, në datën përkatëse të pozicionit financiar. Vlera kontabel e një aktivitet është zhvlerësuar menjëherë në vlerën e tij të rikuperueshme nëse vlera kontabel e aktivitet është më e madhe sesa shuma që vlerësohet të rikuperohet.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet e aktiveve, janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën e aktivitet. Keto janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3.3 Instrumentet financiare

Shoqeria fillimisht njihet llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat monetare në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivitet e tjera financiare (duke përfshirë aktivitet e përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqeria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Shoqeria c'registron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivitet financiar mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse nga aktivitet financiar në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitet financiar janë transferuar. Cdo interes në aktivitet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqeria është njohur si një aktiv apo detyrim i vecantë. Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqeria ka të drejtë ligjore për të netuar shumën dhe synon ose të shlyejë mbi një bazë neto ose të realizojë aktivitetin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo-derivativë të Shoqerisë përfshijnë llogaritë e kërkesa të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjetet monetare, dhe furnitoret dhe detyrime të tjera.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë parate e mbajtura në bankat lokale në monedhën vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto

Llogari e kërkesa të arkëtueshme dhe Llogari e kërkesa të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metoden e interesit efektiv, duke zbritur provigjonet për zhvlerësim. Një provigjon për zhvlerësimin i llogarive të arkëtueshmeve krijohet kur ka evidence objektive se Shoqeria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumën sipas kushteve fillestare të llogarive të arkëtueshmeve.

Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar, dhe mospagesa ose vështirësi në pagesa konsiderohen si tregues se llogaria e arkëtueshme është zhvlerësuar.

Shuma e provigjonit është diferenca midis vlerës kontabel të aktivitet dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Aktivitet me maturim të shkurtër nuk janë skontuar. Vlera kontabel e aktivitet zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie zbritje, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, ajo është zbritur kundrejt llogarisë së zhvlerësimit për llogarisë e arkëtueshme. Rikuperimet pasuese të shumave të zbritura më parë janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Furnitoret dhe detyrime të tjera

Furnitorët dhe detyrime të tjera janë pasqyruar fillimisht me vlerë të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metoden e interesit efektiv.

Huatë dhe kreditë

Huatë dhe kreditë maten fillimisht me vlerën e drejtë, neto për kostot e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, ndërkohë që shpenzimet e interesit njihen me normën efektive të interesit.

Metoda e interesit efektiv është një metode e llogaritjes së kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e regjistrimit të shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat e ardhshme monetare të vlerësuar gjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, kur është e pershtatshme, gjatë një periudhe më të shkurtër.

3.4 Zhvlerësimet

Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka një evidencë objektive se ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar është zhvlerësuar nëse evidenca objektive tregon se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka pasur një efekt negativ mbi flukset e ardhshme monetare të atij aktiviteti që mund të matet me besueshmeri.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferenca midis vlerës kontabel dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të vlerësuar të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi perkundrejt llogarive të arketueshme. Interesat mbi aktivitetet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pasuese ndikon në uljen e shumës së zhvlerësimit, renia në humbjen nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Aktivitetet jo-financiare

Vlerat kontabel e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohen në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parase dhe rreziqet specifike për aktivitetin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbja nga zhvlerësimi njihet në vlerën kontabel e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (në fitim ose humbje).

3.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve.

Të ardhurat maten duke ju referuar vlerës së drejtë të shumës së marrë ose të arketueshme nga Shoqëria për mallrat e shitura dhe të shërbimeve të ofruara, duke përjashtuar taksat e shitjeve, rimbursimet, dhe skontot tregtare.

Shoqëria zbaton kriteret e njohjes se të ardhurat të përcaktuara më poshtë për secilin komponent të identifikueshem të transaksionit të shitjes për të reflektuar thelbin e transaksionit. Shuma e marrë nga keto transaksione është ndarë në komponentin e vecantë të identifikueshem duke marrë parasysh vlerën relative të drejtë për çdo komponent.

Të ardhurat njihen kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, mbledhja është e mundshme, shpenzimet e bëra ose që do të behen të mund të maten me besueshmeri, dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të Shoqërisë janë përmbushur. Keto kritere njohje sipas aktivitetëve specifike janë të bazuara në mallrat apo zgjidhjet e ofruara për konsumatorin dhe kushtet e kontratës në çdo rast, dhe janë përshkruar më poshtë:

Shitja e mallrave me shumicë dhe pakicë

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur produktet i janë shitur klientëve.

Dhënia e shërbimeve

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve janë njohur në periudhën në të cilën janë kryer shërbimet.

Të ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit mbi fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet në valutë të huaj.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huamarrjet, humbjet në valute të huaj, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, dhe humbjet e njohura nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

Fitimet dhe humbjet nga kembimi valutor raportohen në baza neto.

3.6 Inventarët

Inventari paraqitet me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme përfaqëson cmimin përfundimtar të shitjes për inventaret minus të gjitha kostot e vleruara të kompletimit dhe shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

3.7 Qeratë

Percaktimi nëse një marrëveshje është ose përmban terma qiraje, bazohet në përmbajtjen e marrëveshjes në datën e fillimit të saj, nëse përmbushja e marrëveshjes ka të bëjë me përdorimin e aktivitetit, ose aktiveve specifike ose marrëveshja përcakton të drejtën e përdorimit të aktivitetit, edhe pse e drejta nuk është shprehur qartë në një marrëveshje.

Shoqëria si qeramarrës

Qiratë financiare të cilat transferojnë tek shoqëria në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që shoqërojnë pronësinë e aktivitetit të marrë me qira, kapitalizohen në momentin e fillimit të qerases me vlerën e drejte, ose në të kundërt, nëse vlera e drejte është më e vogël, me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qirasë. Pagesat e qirasë shpërndahen mes detyrimeve financiare dhe zvogelimit të detyrimit të qirasë, në mënyrë që të sigurohet një normë interesi e qëndrueshme në balancën e mbetur të detyrimit. Detyrimet financiare njihen si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Një aktiv i marrë me qira financiare amortizohet përgjatë jetës së dobishme të tij. Megjithatë, nëse në fund të periudhës së qirasë, nuk ekziston një mundësi e arsyeshme që shoqëria të fitojë pronësinë mbi aktivin, aktiviteti amortizohet përgjatë periudhës më të shkurtër midis jetës së dobishme të vlerësuar dhe kohëzgjatjes së qirasë.

Pagesat e qirase operative njihen si një shpenzim operativ në pasqyrën e të ardhurave, bazuar në metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

3.8 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me Legjislacionin Shqiptar mbi Tatimin mbi Fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje për sa kohë që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose substancialisht në fuqi në datën e raportimit, dhe cdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi aktual mbi fitimin është llogaritur me 15% (2016: 15%) të fitimit të tatueshem.

Tatimi i shtyre është njohur duke përdorur metodën e bilancit kontabel, nga diferencat e perkohshme ndërmjet vlerës kontabel të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të perkohshme kur ato të ndryshojnë, bazuar në ligjet që janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyre njihet për sa kohë është e mundur që fitimi i tatueshem i ardhshëm të jetë në dispozicion kundrejt të cilit mund të përdoret ndryshim i perkohshëm. Aktivitetet e tatimit të shtyre (nese ka) janë rishikuar në secilin datë të raportimit dhe janë reduktuar deri në masën ku nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

3.9 Përfitimet pas-daljes në pension dhe planet e pensione

Shoqëria kryen vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që ofrojnë punonjësve përfitime pas daljes në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për percaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të percaktuar. Kontributet e shoqërisë ndaj planit të pensioneve janë ngarkuar në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

3.10 Kapitali

Kapitali aksioner përbëhet prej mjeteve monetare të kontribuar nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksioner mbahet në shumën e konvertuar lekë të monedhës së huaj të marrë, duke përdorur kursin e kmbimit në datën e transaksionit.

3.11 Provigjonet

Një provigjon njihet kur Shoqëria kë një detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve të mëparshme dhe është e mundur që të ketë një dalje të burimeve që përfaqësojnë përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe mund të behet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Provigjonet rishikohen në cdo datë të pozicionit financiar dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të pasardhshme është material, shumën e provigjonit është vlera aktuale e shpenzimeve të pritshme të nevojshme për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

3.12 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shenimet shpjeguese përveç rasteve kur mundësia e një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është shumë e ulët. Një aktiv i kushtëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare por është pasqyruar në shenimet shpjeguese kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes së kushtëzuar është njohur si provigjon nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmohen dhe se mund të bëhet një vleresim i arsyeshëm i shumës së humbjes në datën e pozicionit financiar.

3.13 Transaksionet e paleve të lidhura

Palet e lidhura janë ato ku njëra nga palet është e kontrolluar nga tjetra, ose ka ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare apo të biznesit të palës tjetër.

3.14 Ngjarje pas periudhës së raportimit

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e shoqërisë në datën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë pasqyruar në shënime kur janë materiale.

4. Emri i mirë

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Dyrrah CATV	132,231,148	-
First-nation	128,919,823	-
Star dhe Trio	110,392,113	110,392,113
Lushi CATV	88,638,740	-
Kruja TV	12,685,850	-
A-Vision	10,904,629	-
Vlera e mbartur e emrit të mirë	483,772,803	110,392,113

Më 30 qershor 2014, shoqëria Abcom shpk ka përfunduar përthithjen e shoqërive Trio Tv shpk dhe Star TV shpk. Llogaritë e investimit për këto shoqëri janë mbyllur me llogaritë e kapitalit dhe diferenca është regjistruar si "Emër i mirë".

Në datë 31 Dhjetor 2017 ABCOM shpk ka përthithur kompanitë Dyrrah CATV, First Nation, Lushi CATV, Kruja TV dhe A-Vision në bazë të vendimit të aksionerëve. Llogaritë e investimit për këto kompani janë mbyllur me llogaritë e kapitalit dhe diferenca është regjistruar si Emër i Mirë.

Kompania ka kryer testin për zhvlerësimin e Emrit të Mirë dhe rezultati është se nuk ka nevojë për njohje zhvlerësimi për emrin e mirë.

ABCOM sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017

5. Aktivet afatgjata materiale

	Ndërtesa	Sisteme telekomunikacioni dhe instalime të pergjithshme	Mjete Transporti	Pajisje zyre dhe informatike	Aktive në proces	Total
Kosto						
Në 1 Janar 2016	62,929,221	3,630,152,205	70,334,428	99,467,189	649,193,335	4,512,076,378
Shtesa	-	-	-	-	535,112,836	535,112,836
Riklasifikime	(516)	(30,439)	-	(8,093)	7,138,312	7,099,264
Shitje dhe dalje jashtë përdorimi	(4,804)	(177,238,929)	(7,354,200)	(196,253)	(23,128,560)	(207,922,746)
Transferime të aseteve në operacione	1,073,534	694,436,970	3,412,303	9,052,178	(707,974,985)	-
Në 31 Dhjetor 2016	63,997,435	4,147,319,807	66,392,531	108,315,021	460,340,938	4,846,365,732
Shtesa	-	-	-	-	670,131,465	670,131,465
Riklasifikime	2,071	(374,666)	-	8,530	1,079,910	715,845
Shitje dhe dalje jashtë përdorimi	(13,078)	(63,152,305)	-	(1,419,923)	(10,666,535)	(75,251,841)
Shtesa ne kosto nga kompanite e perthithura	-	138,933,549	-	-	-	138,933,549
Transferime të aseteve në operacione	3,181,940	720,881,992	2,841,669	22,832,769	(749,738,370)	-
Në 31 Dhjetor 2017	67,168,368	4,943,608,377	69,234,200	129,736,397	371,147,408	5,580,894,750
Zhvlerësimi i akumuluar						
Në 1 Janar 2016	(53,558,752)	(1,880,919,207)	(50,816,877)	(78,793,907)	-	(2,064,088,743)
Riklasifikime	3	(10,817)	1	2,700	-	(8,113)
Zhvlerësimi I vitit	(3,699,661)	(458,376,050)	(5,996,859)	(7,853,109)	-	(475,925,679)
Shitje dhe dalje jashtë përdorimi	881	163,870,240	7,354,200	113,566	-	171,338,887
Në 31 Dhjetor 2016	(57,257,529)	(2,175,435,834)	(49,459,535)	(86,530,750)	-	(2,368,683,648)
Zhvlerësimi I vitit	(3,528,255)	(513,155,581)	(6,183,799)	(10,230,318)	-	(533,097,953)
Shitje dhe dalje jashtë përdorimi	10,599	45,553,043	-	752,065	-	46,315,707
Amortizim të akumuluar nga përthithja	-	(46,426,058)	-	-	-	(46,426,058)
Në 31 Dhjetor 2017	(60,775,185)	(2,689,464,430)	(55,643,334)	(96,009,003)	-	(2,901,891,952)
Vlera kontabel neto në 31 Dhjetor 2016	6,739,906	1,971,883,973	16,932,996	21,784,271	460,340,937	2,477,682,084
Vlera kontabel neto në 31 Dhjetor 2017	6,393,183	2,254,143,947	13,590,866	33,727,394	371,147,408	2,679,002,798

6. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale janë analizuar si me poshtë:

	Licenca	Aktive në process programme dhe licenca	Total
Kosto			
1 January 2016	61,342,120	2,802,397	64,144,517
Shtesa	-	793,778	793,778
Zhvleresim	-	-	-
Riklasifikime	39,044	-	39,044
Transferime	1,176,028	(1,176,028)	-
Në 31 Dhjetor 2016	62,557,192	2,420,147	64,977,339
Shtesa	26,686	-	26,686
Riklasifikime nga AAM	(160)	(1,347,018)	(1,347,178)
Transferime	1,073,129	(1,073,129)	-
Në 31 Dhjetor 2017	63,656,847	-	63,656,847
Amortizimi			
Në 1 January 2016	(49,170,457)	-	(49,170,457)
Amortizimi i vitit	(5,558,157)	-	(5,558,157)
Riklasifikime	8,115	-	8,115
Në 31 Dhjetor 2016	(54,720,499)	-	(54,720,499)
Amortizimi i vitit	(4,587,388)	-	(4,587,388)
Në 31 Dhjetor 2017	(59,307,887)	-	(59,307,887)
Vlera kontabel neto			
Në 31 Dhjetor 2016	7,836,693	2,420,147	10,256,840
Në 31 Dhjetor 2017	4,348,959	-	4,348,959

Aktivët afatgjata jomateriale regjistrohen fillimisht si aktive në proces dhe me pas klasifikohen si aktive afatgjata jomateriale kur janë gati për përdorim.

7. Investime

Pjesëmarrjet e ABCOM në shoqëri të lidhura të vleresura me kosto janë detajuar si me poshtë:

	Kuota %	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Investimi tek Dyrrah CATV shpk	100	-	160,931,148
Investimi tek First Nation shpk	100	-	144,249,822
Investimi tek Lushi CATV shpk	100	-	117,856,740
Investimi tek A-Vizion shpk	100	-	53,104,630
Investimi tek Kruja TV shpk	100	-	36,371,400
Investimi tek Scuttary Shpk	100	24,242,400	-
Investimi tek Mbrostallar Shpk	100	18,071,100	-
Totali		42,313,500	512,513,740

8. Inventari

Inventari është pasqyruar si me poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aksesorë	13,934,641	8,843,848
Materiale promicionale	3,035,277	2,057,564
Karta rimbushese dhe materiale te tjera	409,855	434,488
Totali	17,379,773	11,335,900

9. Llogari të arketueshme

Llogarite e arketueshme janë detajuar si me poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari te arketueshme	75,572,054	67,347,351
Provizione për llogari të pambledhshme	(3,565,328)	(3,197,918)
Totali	72,006,726	64,149,433

Drejtimi i kompanisë ka bërë provizion për borxhin e keq në vlerën 3,565,328 Lekë për vitin 2017 i cili është klasifikuar si shpenzim i panjohur për efekte të llogaritjes së tatimit fitimit. (2016: 3,197,918 Lekë)

10. Llogari të tjera të arketueshme

Llogaritë e tjera të arketueshme janë detajuar si me poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Parapagime per furnitore	29,182,661	7,523,412
Shpenzime të periudhave të ardhshme	15,242,916	19,382,146
Detyrime nga ish-pronaret e STAR TV	2,657,023	2,657,023
Pagesa në pritje proces gjyqesor	1,100,270	7,726,938
TVSH e arketueshme	75,089	33,984,074
Te tjera	908,392	22,461,347
Te drejta nga pale te lidhura	0	4,807,486
Totali	49,166,351	98,542,426

Pagesa në pritje proces gjyqesor - Shoqëria në 27.09.2016 ka fituar në gjykatën e apelit administrativ gjyqin për depozitat e garancive për pajisjet e dhena klientëve ndaj Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën 20,989,288 Lekë. Shoqërisë i janë rimbursuar 14,969,621 Lekë në vitin 2016, dhe diferenca në vlerën 6,019,667 lekë është rimbursuar në vitin 2017. TVSH e arketueshme – Shoqëria në date 30.05.2017 ka fituar në gjykatën e lartë gjyqin për tvsh e rimbursueshme për shërbimet e interkoneksionit ndaj Tatim Paguesve të Mëdhenj në vlerën 33,887,575 Lekë. Shoqërisë i është rimbursuar plotësisht TVSH e arketueshme brenda vitit 2017.

11. Mjete Monetare

Mjetet monetare janë si vijon:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Arka		
- në monedhe vendase	16,907,893	6,310,677
- në monedhën EUR	1,266,897	257,317
- në monedhën USD	15,847	16,106
	18,190,636	6,584,099
Llogari rrjedhëse në banka		
- në monedhe vendase	63,654,131	67,893,801
- në monedhën EUR	93,135,122	35,015,574
- në monedhën USD	2,339,612	1,669,034
	159,128,865	104,578,409
Mjete Monetare në tranzit	867,773	713,436
Totali i mjeteve monetare	178,187,273	111,875,945

12. Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Më 31 Dhjetor 2017, sipas Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) datë 14 Shkurt 2017 totali i kapitalit të regjistruar është 1,358,611,854 Lekë. Shoqëria në Korrik 2017 ka bërë zvogelim kapitali në vlerën 6,632,500 lekë.

	2017	2016	%
American Broadband B.V.	1,358,611,854	1,365,244,354	100%
	1,358,611,854	1,365,244,354	100%

Rezerva ligjore dhe të tjera

Rezervat ligjore janë krijuar në përputhje me "Ligjin për Shoqëritë Tregtare" i kërkon shoqërisë të krijojë rezervë ligjore. Balanca e rezerva ligjore më 31 Dhjetor 2017 është 34,427,207 Leke (2016: 34,427,207 Leke).

Balanca e rezerva të tjera është krijuar nga fitimi i pashpërndarë i viteve të mëparshme dhe nga rezervat e shoqërive Trio TV dhe Star TV që u përthithen nga Abcom me 30.06.2014 dhe nga rivlerësimi i bërë në 31.12.2015, kjo balance më 31 Dhjetor 2017 është 1,454,585,900 Leke. Duke filluar nga 01 Janar 2016 shoqëria ABCom shpk raporton sipas Standarteve Nderkombëtare të Kontabilitetit dhe ka kryer të tërë rregullimet e nevojshme për kalimin nga SKK në SNK, të gjithë ndryshimet janë reflektuar në rezerve për investime duke qënë se fitimet e pashpërndara cdo vit janë kaluar në rezervë për investime.

Fitimi i pashpërndarë

Fitimi i pashpërndarë në vlerën 203,699,412 Lekë përbëhet nga fitimi i vitit 2017 për shoqërinë ABCom shpk në vlerën 266,757,330 Lekë, fitimi i pashpërndarë i STAR TV në datë 30.06.2014 në vlerën 1,985,182 Lekë, humbja e shoqërisë TRIO TV në datë 30.06.2014 në vlerën (1,998,645) Lekë, humbja e shoqërisë Avision në datë 31.12.2014 në vlerën (19,636,436) Lekë, humbja e shoqërisë Dyrrah CATV në datë 31.12.2017 në vlerën (7,151,252) Lekë, humbja e shoqërisë First Nation në datë 31.12.2017 në vlerën (5,373,948) Lekë, humbja e shoqërisë Kruja TV në vlerën (12,011,380) Lekë, humbja e shoqërisë Lushi CATV në datë 31.12.2017 në vlerën (6,218,533) lekë dhe efektet e tranzicionit kalimit nga SKK në SNK në vlerën (15,620,163) Lekë.

13. Qera Financiare

Huamarrjet afatshkurtër dhe afatgjatë janë detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Huamarrje afat-shkurtër		
Tirana Leasing – Qira financiare	-	1,289,750
RZB – Qira financiare	1,163,357	2,783,314
Porsche Leasing – Qira financiare	1,031,869	2,428,924
Totali huamarrje afat-shkurter	2,195,226	6,501,988
Huamarrje afat-gjatë		
Tirana Leasing – Qira financiare	-	-
RZB – Qira financiare	-	1,173,337
Porsche Leasing – Qira financiare	636,044	1,682,218
Totali huamarrje afat-gjatë	636,044	2,855,555
Qera Financiare	2,831,270	9,357,543

14. Llogari të pagueshme

Furnitorët përfshijnë kryesisht detyrimet kundrejt furnitorëve të huaj dhe vendas.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Furnitorë Vendas	49,053,773	45,416,938
Furnitorë të Huaj	30,603,504	39,860,424
Furnitor	79,657,277	85,277,362

15. Te ardhura të marra në avancë

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Të ardhura të shtyra Internet, TV dhe telefoni	179,865,489	173,725,575
Të ardhura të shtyra të tjera	1,124,107	1,980,703
Totali	180,989,596	175,706,278

Të ardhurat e marra në avance lidhen me pagesa të bëra kryesisht për kontrata nga një deri në dy vjet për shërbimet e ofruara nga ABCOM.

16. Detyrime të tjera rrjedhëse dhe të përlogaritura

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Garanci-Klientë	243,797,283	239,710,930
Detyrim për blerjen e Mbrostallar shpk	12,054,531	(0)
Furnitorë për fatura të pambërritura	8,165,255	3,058,861
Sigurime shoqerore dhe shëndetësore	7,867,815	7,289,445
TVSH e pagueshme	7,150,849	21,904,931
Tatim në burim	4,784,515	4,418,566
Kosto Personeli	1,044,162	2,182,805
Të tjera	8,391,733	6,711,746
Detyrim për blerjen e Lushi CATV	0	74,376,500
Totali	293,256,143	359,653,783

Shoqëria merr garanci nga klientët për të garantuar mbarëvajtjen e kontratës. Vlera e garancisë i kthehet klientit në momentin e mbylljes së kontratës. Nëse klienti nuk kthen pajisjen kur përfundon shërbimi brenda afateve të percaktuara atëherë pajisja i shitet klientit.

17. Te ardhura

Shoqëria ofron shërbime interneti, televizioni dhe telefoni për individë dhe biznese. Te ardhurat janë analizuar si me poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga shërbimet	1,781,768,321	1,741,519,288
Të tjera	9,767,169	6,923,057
Totali	1,791,535,490	1,748,442,345

18. Të ardhura të tjera operative

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e aktiveve	49,117,823	60,122,260
Të ardhura të tjera	2,743,709	7,915,201
Totali	51,861,532	68,037,461

19. Furnizim materiale dhe shërbime

Kostoja e materialeve, tarifat e internetit, dhe shpenzime të tjera direkte janë detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Të drejta TV	163,989,115	141,377,428
Kosto aksesi në internet	140,249,096	143,169,773
Kosto telefonie	44,277,933	70,556,819
Qera dhe shpenzime utilitare	33,752,392	29,375,672
Riparime dhe mirëmbajtje	19,462,420	20,473,102
Blerje materiale	10,231,768	9,179,505
Te tjera	6,762,525	7,954,800
Totali	418,725,249	422,087,099

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet për personelin përfshijnë si vijon:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Paga dhe shpërblime	280,901,214	281,265,835
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	34,021,569	33,949,636
Totali	314,922,783	315,215,471

21. Shpenzime të tjera operative

Shpenzimet administrative dhe të tjera operative përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime utilitare dhe qera	62,364,593	59,132,383
Shpenzime marketingu	58,063,605	53,612,977
Shitje e aktiveve afatgjata	25,166,600	31,432,986
Tarifa dhe licenca	19,949,924	17,362,758
Blerje materiale konsumi	16,763,177	12,650,168
Komision shitje	12,445,615	9,848,989
Sherbime profesionale dhe të tjera	9,177,810	12,807,810
Taksa të tjera	6,846,688	8,202,795
Trajnime dhe evente BNJ	5,156,614	1,676,856
Komisione bankare	4,275,094	3,997,242
Shpenzime siguracioni	3,518,866	4,408,045
Kosto transporti	1,574,745	1,134,279
Të tjera	20,482,230	17,337,031
Totali	245,785,561	233,604,319

22. Të ardhurat/(shpenzimet) financiare

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo të porealizuara nga kurset e këmbimit, të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat, dhe të tjera të ardhura financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime interesi	(629,817)	(4,014,709)
Humbje nga kursi I këmbimit	(11,744,135)	(13,809,754)
Shpenzime financiare	(12,373,952)	(17,824,463)
Të ardhura nga interesi	18,799	38,787
Fitim nga kurset e këmbimit	7,908,262	11,048,536
Humbjet neto nga kurset e këmbimit	7,927,061	11,087,323
Totali i të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	(4,446,891)	(6,737,140)

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit fitimit rakordon me fitimin kontabël për vitin 2017 dhe 2016 si me poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
1 Të ardhura të ushtrimit	1,851,324,083	2,227,747,311
2 Të ardhura tatimore	1,851,204,083	2,227,482,501
3 Shpenzime ushtrimi	1,533,058,211	1,859,848,183
4 Shpenzime tatimore	1,460,091,581	1,859,848,183
5 Shpenzime të panjohura	56,412,189	42,224,950
Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3)	447,524,691	409,859,268
6 Humbje të mbartura (-)	-	-
7 Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3)	447,524,691	409,859,268
8 Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
Shpenzim tatim fitimi	67,128,704	61,478,890
9 Tatim fitimi i shtyre	-	-
10 Tatim fitimi I parapaguar	64,978,205	67,905,155
11 Tatim fitimi (i arkëtueshem) i pagueshëm	2,150,499	(6,426,265)

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Tatim Fitimi shpenzim I vitit	(67,128,704)	(61,478,890)
Taksë e shtyrë	15,620,164	2,060,581
Shpenzim I tatim fitimit	(51,508,540)	(59,418,309)

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Gjëndje në 1 Janar	33,984,105	31,923,524
Taksë e shtyrë	15,620,163	2,060,581
Shpenzim I tatim fitimit	49,604,268	33,984,105

24. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara

Angazhime

Shoqëria ka angazhime në lidhje me ambientet e marra me qira në funksion të aktivitetit.

Pagesat minimale sipas marrëveshjes janë si me poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Deri në 1 vit	41,392,289	34,141,126
Nga 1 deri në 5 vjet	44,776,200	38,035,180
Mbi 5 vjet	-	-
Totali	86,168,489	72,176,306

Detyrime tatimore

Librat dhe të dhënat kontabël për vitet financiare që përfundojnë më 31 Dhjetor 2017 nuk janë audituar nga ana tatimore.

Çështje gjyqësore

Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare 31 Dhjetor 2017, nuk ka asnjë çështje gjyqësore të ngritur kundër shoqërisë së përveç atyre të mbartura nga vitet e shkuara.

25. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kenë nevojë për rregullime apo prezantime shtesë në këto pasqyra financiare.

Deklarata e hartuesit të pasqyrave financiare

Për Drejtimin e

Abcom sh.p.k


Ne jemi angazhuar për të asistuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të Abcom shpk për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017.

Përgjegjësia jonë është të hartojmë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Kontabilitetit që janë të përfshira në ligjin Nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin Nr. 9477 date 09.02.2006 dhe me urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 65 date 05.05.2008 dhe në përputhje me politikat kontabël të Kompanisë.

Tirana,
19 Shkurt 2018



Prof. Dr. Agim Binaj CA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCES
KABINETI

Bulevardi "Deshmoret e Kombit" Tirane, Albania Tel. 355-42-28405, Fax. 355-42-28494

DESHMI

PER KONTABLIN E MIRATUAR

Kjo Deshmi i leshohet,

Z/Zj. AGIM.....JONUZ.....BINAJ.....

per ta lejuar ate te ushtroje Profesionin e


Kontablit te Miratuar.

Kjo deshmi leshohet nen kontrollin e Ministrise se Financave.

Nr...395.....

Date 17.07.1998

MINISTRI
Arben MALAJ



Pasqyra e TVSH dhe rakordimi me të dhënat kontabël

Mënyë	Te përfaqësuar, m e TVSH jo që zbritshme/pe pa TVSH	Blerje investime brenda vendit		Importe të investimit me shkatillo 20%		Importe të investimit me shkatillo 20%		Nga Furnitore Vendas me shkatillo 20%		Te Investimit nga Furnitore Vendas me shkatillo 20%		Autogartese TVSH ne Blerje		Shiçe pa tvsh		Eksporte mallirash		Shiço me shkatillo 20%		Autogartese TVSH ne shiçe		STAR dhe TRIO 30.06.2014		TVSH pagu/imb		
		Blerje investime brenda vendit		Importe të investimit me shkatillo 20%		Importe të investimit me shkatillo 20%		Nga Furnitore Vendas me shkatillo 20%		Te Investimit nga Furnitore Vendas me shkatillo 20%		Autogartese TVSH ne Blerje		Shiçe pa tvsh		Eksporte mallirash		Shiço me shkatillo 20%		Autogartese TVSH ne shiçe		STAR dhe TRIO 30.06.2014				
		Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vl. Tabesh	Zbritshme	Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vlera e Tabeshime	Tvsh	Vlera e Tabeshime	Tvsh		Vlera e Tabeshime	Tvsh
Janar	23,689,887	707,392	31,624,464	6,324,883	7,097,811	8,774,821	1,754,964	37,927,400	7,585,468	10,969,186	-	-	172,705,309	34,541,002	37,927,400	7,585,468	-	-	172,705,309	34,541,002	37,927,400	7,585,468	-	-	19,254,965	
Shkurt	8,603,659	727,223	4,731,786	23,689,929	6,950,184	12,728,661	2,445,732	36,188,815	7,237,763	9,902,377	668,145	668,145	132,967,158	26,413,432	36,188,815	7,237,763	-	-	132,967,158	26,413,432	36,188,815	7,237,763	-	-	12,172,900	
Mars	8,705,788	691,772	6,162,473	9,912,367	5,094,665	10,620,730	2,124,146	40,516,051	8,103,610	10,793,349	-	-	144,331,494	28,986,299	40,516,051	8,103,610	-	-	144,331,494	28,986,299	40,516,051	8,103,610	-	-	19,681,572	
Prill	7,141,719	755,084	4,815,096	24,075,481	33,191,620	6,638,364	15,948,457	3,189,691	48,671,196	9,734,237	10,836,062	9,869,169	138,145,363	27,629,077	48,671,196	9,734,237	-	-	138,145,363	27,629,077	48,671,196	9,734,237	-	-	12,571,742	
Maj	7,417,064	1,130,139	131,574	26,765,501	33,677,241	6,763,448	2,136,545	40,642,208	8,128,442	10,988,102	9,869,169	138,145,363	27,629,077	40,642,208	8,128,442	-	-	138,145,363	27,629,077	40,642,208	8,128,442	-	-	12,946,668		
Qershor	12,620,678	1,033,753	7,239,954	31,768,333	6,357,261	22,929,760	4,655,952	43,891,626	8,778,321	10,360,320	-	-	133,574,846	26,714,970	43,891,626	8,778,321	-	-	133,574,846	26,714,970	43,891,626	8,778,321	-	-	8,765,916	
Korrik	7,436,263	1,520,931	14,336	3,625,157	25,612,386	5,122,477	15,082,978	3,016,596	46,361,682	9,272,338	10,919,918	109,918	141,314,498	28,262,894	39,929,654	7,965,931	-	-	141,314,498	28,262,894	39,929,654	7,965,931	-	-	9,935,083	
Gusht	7,291,884	947,597	277,224	29,986,364	5,997,273	30,384,388	6,076,878	30,991,178	6,198,236	8,051,951	10,919,918	109,918	141,314,498	28,262,894	39,929,654	7,965,931	-	-	141,314,498	28,262,894	39,929,654	7,965,931	-	-	16,641,571	
Shator	8,509,020	969,335	551,506	25,442,594	5,086,519	29,333,122	5,986,624	13,466,469	2,869,298	43,969,741	8,798,746	10,221,677	133,574,846	26,714,970	46,361,682	9,272,338	-	-	133,574,846	26,714,970	46,361,682	9,272,338	-	-	14,947,872	
Tetor	10,940,162	968,059	2,324,517	464,903	13,019,127	2,603,825	26,215,969	5,643,194	12,665,463	2,573,083	13,466,469	2,869,298	43,969,741	8,798,746	43,969,741	8,798,746	-	-	133,574,846	26,714,970	46,361,682	9,272,338	-	-	9,935,083	
Netor	11,166,792	1,540,886	4,003,629	812,726	40,930,316	8,186,064	32,059,337	6,411,867	21,346,874	4,209,975	49,844,113	9,968,623	6,874,287	144,459	144,459	151,310,086	30,262,019	-	-	151,310,086	30,262,019	66,085,726	13,217,145	-	-	16,641,571
Dhjetor	10,966,362	1,017,243	53,446	34,814,295	6,962,859	36,196,144	7,237,229	19,514,290	3,902,868	80,126,164	12,025,633	7,847,183	-	-	-	172,914,875	34,552,975	-	-	172,914,875	34,552,975	66,126,164	12,025,633	-	-	16,469,340
Totali	124,610,938	12,229,426	9,168,169	316,654,997	63,310,999	376,301,012	76,260,202	194,966,426	38,397,086	114,782,146	10,869,711	10,869,711	1,766,630,669	351,966,132	564,183,386	110,836,877	110,836,877	10,869,711	10,869,711	1,766,630,669	351,966,132	564,183,386	110,836,877	(76,089)	(76,089)	171,964,207

TVSH (per tupe as per TB DF) 16,469,340 (7,160,660) 9,316,460

TVSH e rimbu DF 76,089 0

OK sipas FDI Kompenzuar e sere vlera Kompenzuar e sere vlera Kompenzuar e sere vlera

TVSH (per tupe as per TB DF) 16,469,340 (7,160,660) 9,316,460

TVSH e rimbu DF 76,089 0

Kuadrimi i ardhjeve me asteriskin F5 dhe PASH

Sipas Sistemit	Kumulativë	31-Qe-e-17
Revenue	1,843,397,021	
Te ardhura te shunata ne 2017 qe matuheshin	180,441,766	1,781,768,321
Autobulumë	554,183,382	9,767,169
Personel rradhesa	174,746	1,791,535,490
Genanci: Pajisje te shunata 411029	38,326,910	
Provizion te ardhura	0	
Te ardhura te shunata ne vitet e meparstme	(175,169,947)	
Mbyllje detyrim furnitore	(171,763)	
Faturim shiçe ne 4 (distribucion)	(254,056)	
Te ardhura nga gjyq i ERT	(4,074,000)	
Te tjera	(268,119)	
Totali	2,436,605,901	0
Diff		

Pasqyra e pagave dhe rakordimi me te dhënat kontabël

Nr	Nr Punonjes ve	Paga bruto	11) Mbi te cilen llogariten kontributet	1					12) Gjithsej = (13+14+15)	15) Kontribut shtese	16) Kontribute per sigurimet shendetesore gjithsej ne leke	18) Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi ne leke	Kapitalizim paga sipas situacioneve IFRS/TAX
				Nga keto:									
		10) Gjithsej		13) Udhëheqës	14) Udhëheqës	15) Udhëheqës	16) Udhëheqës	17) Udhëheqës					
1	Muaji												
1	Janar	31,934,768	24,271,051	3,640,709	2,305,773	-	-	-	1,084,271	3,157,779	8,883,047	8,883,047	
2	Shkurt	30,850,731	23,455,421	3,518,364	2,228,305	-	-	-	1,047,719	3,012,639	8,398,922	8,398,922	
3	Mars	30,678,387	23,460,919	3,452,632	2,186,667	-	-	-	1,036,337	3,000,856	8,255,656	8,255,656	
4	Prill	32,237,499	23,994,816	3,599,270	2,279,533	-	-	-	1,068,945	3,126,574	10,672,521	10,672,521	
5	Maj	32,373,643	25,590,815	3,803,400	2,408,365	-	-	-	1,098,491	3,012,658	10,828,089	10,828,089	
6	Qershor	32,465,851	25,578,689	7,320,345	2,411,766	-	-	-	1,099,945	3,032,868	10,850,064	10,850,064	
7	Korrik	32,639,157	25,689,831	7,388,707	2,436,009	-	-	-	1,106,223	3,033,076	10,858,726	10,858,726	
8	Gusht	32,878,216	25,809,197	7,434,932	2,449,625	-	-	-	1,117,392	3,126,325	10,856,767	10,856,767	
9	Shtator	32,879,058	25,664,286	7,396,658	2,438,133	-	-	-	1,108,824	3,085,983	10,968,747	10,968,747	
10	Tetor	34,675,395	26,875,202	7,722,342	2,548,620	-	-	-	1,149,439	3,302,086	11,740,204	11,740,204	
11	Nentor	34,453,730	27,414,127	7,878,793	2,602,085	-	-	-	1,168,057	3,195,540	11,916,038	11,916,038	
12	Dhjetor	38,244,450	27,077,848	4,058,215	2,570,145	-	-	-	1,159,249	3,727,561	19,756,044	19,756,044	
	TOTALI	396,310,885	304,882,202	45,578,249	28,865,026				13,244,892	37,813,945	133,984,824	133,984,824	

TOTALI 18,377,193
Sipas TAX 152,362,016
Diff 152,360,822
1,195

Kuartrimi I situates me sistemin

Sipas sistemit		Sipas sistemit	
Autongarkese situacione (kapitalizim Paga)	Paga Shpenz	Sistem FDP	Sistem FDP
Shperblime semundie dhe fatkeqesi	314,922,783	-7,786,445	-7,786,445
Sig. Shoqerore te paguara nga punemarresit	133,984,824	7,787,609	7,787,609
Sipas Listepageses	(378,520)	Diff	Diff
	(18,112)	1,164 imm	1,164 imm
	448,511,580	ok	ok
		-605 imm	-605 imm
		ok	ok
		TAP detyrim	TAP detyrim
		-3,727,671	-3,727,671
		3,727,561	3,727,561

Dif